



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 521/2 Prot.

Tiranë, më 06.05.2025

V E N D I M

Nr. 110, Datë 06.05.2025

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja b), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi² mori në shqyrtim ankesën me nr. 67 Regj., datë 20.03.2025, paraqitur nga Shoqata “Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri”, kundër medias online, Revista Bordo/Youtube³, në të cilën pretendohet për diskriminim në formën e “gjuhës së urrejtjes”, për shkak të “gjinisë”, kundrejt grave e vajzave.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, subjekti ankues, Shoqata “Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri” (në vijim referuar me akronimin RRFSGH apo si Shoqata), ka parashtruar si vijon:

“Më 14 mars 2025, në kanalin Youtube të Revistës Bordo është publikuar një video e shkurtër me titull: A. L: “Nuk ka femra të vështira, ka femra që s’pinë alkool!”

¹ Në vijim do t’i referohemi me akronimin LMD.

² Në vijim do t’i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

³ <https://www.youtube.com/channel/UCvRRhdj6rHqr4bceJT3YiiQ>

Gjuha e përdorur në bisedën e transmetuar online, është shprehje publike që promovon dhe nxit denigrimin, urrejtjen, stereotipizimin negativ dhe stigmatizimin ndaj vajzave dhe grave.

Ndër një sërë komentesh boshe dhe zvogëluese për vajzat dhe gratë ndodh edhe shkëmbimi i mëposhtëm:

Gazetarja: Çfarë konsideron një femër të vështirë?

- *Është një shprehje që thotë: “Nuk ka femra të vështira, ka femra që s’pinë alkool! Nuk besoj se ka femra të vështira, besoj se ka meshkuj që kanë probleme ekonomike dhe janë të paaftë për të menaxhuar dhe manipuluar mendjen e një femre.”*

Dhënia e alkoolit vajzave dhe grave apo dehja e tyre, është një nga taktikat që përdhunuesit përdorin për të abuzuar me to, kudo në botë. Pirja e alkoolit ul vetëdijen e individit dhe vështirëson aftësinë e tij/saj për të dhënë pëlqimin. Alkooli konsiderohet si “date rape drug”, mjeti më i përdorur nga dhunuesit për të kryer dhunë seksuale.

Shpërndarja e vetëdijshme e kësaj lloji përmbajtjeje mbart rrezikun e nxitjes së dhunës seksuale ndaj vajzave dhe grave.

Shpërndarja dhe promovimi i narrativës se djemtë dhe burrat duhet të kenë aftësi dhe para për të manipuluar vajzat dhe gratë, rrit presionin shoqëror ndaj tyre, nxit dhunë dhe përbën një formë dhune psikologjike.”

Përfundimisht subjekti ankues kërkon nga Komisioneri: “Heqjen e përmbajtjes, kërkimin e një ndjese publike, krijimin dhe diseminimin e përmbajtjes që adreson dhunën me bazë gjinore, dhunën seksuale ndaj grave dhe vajzave, pabarazitë në përfaqësim dhe dhunën me bazë psikologjike për vajzat dhe djemtë.”

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me

Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohej ndaj çdo veprimi apo mosveprimi si të një autoriteti publik, ashtu edhe çdo personi fizik apo juridik që merr pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë.

Bazuar në nenin 32/1/b të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar në nenin 32, pika 2 dhe 33, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Plotësimi i kriterëve formale të një ankese, për të vijuar me shqyrtimin administrativ të saj, është hapi i parë, që ndiqet nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në bazë parashikimeve përkatëse ligjore. Ky detyrim i Komisionerit parashikohet shprehimisht në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”.

Mbështetur në parashikimin e nenit 44, pika 2, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, organi publik shqyrton paraprakisht kërkesën e depozituar nga pala, lidhur me përmbushjen e kriterëve formale ligjore, si kompetenca e organit publik, legjitimitimi, afati, forma dhe çdo kriter tjetër të parashikuar nga ligji.

Në nenin 65, shkronja b), të ligjit të sipërpërmendur parashikohet gjithashtu se: “*Në fillim të procedurës administrative, organi publik kryen verifikimet e mëposhtme:*

.....

b) legjitimitimin e palës që ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedurës administrative.”

Në pikën 1, të nenit 128, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, gjithashtu parashikohet koncepti i legjitimitimit edhe kur pala legjitimohet për të nisur një procedim administrativ. Sipas këtij neni, pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet ligjore administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj të ligjshëm cenohen nga ky veprim apo mosveprim.

Në rast se do t’i referohemi LMD-së, rezulton se në nenin 32, pika 1, të tij parashikohet shprehimisht se:

“1. Komisioneri ka kompetencë:

a) të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj;

b) të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi ose në emër të tyre për çështje që lidhen me interesa kolektive;

c) të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligj.”

Referuar parashikimit të shkronjës b), të pikës 1, të nenit 32, të ligjit të sipërpërmendur rezulton se Komisioneri shqyrton ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve, ose në emër të tyre për çështje që lidhen me interesa kolektive.

“Interesi i ligjshëm” është elementi fillestar që duhet të plotësohet nga një organizatë, OJF, që depoziton ankesë pranë Komisionerit, për mbrojtje të interesave të një komuniteti të caktuar, që nënkupton legjitimitimin aktiv të saj, në paraqitjen e ankesës.

Shoqata “Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri”, është një organizatë jofitimpurëse, regjistruar si person juridik, me vendimin nr. 3224, datë 27.12.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Referuar akteve themeluese, shoqata ka si qëllim dhe objekt të veprimtarisë së saj mbrojtjen e interesave të grave e vajzave në Shqipëri.

Neni 5, i Statutit të Shoqatës “Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri”, përcakton se: “Shoqata, ka si qëllim dhe mision të veprimtarisë së saj, të mbështesë, të mbrojë dhe promovojë të drejtat dhe intereset e grave dhe vajzave në Republikën e Shqipërisë, pavarësisht nga raca, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare e filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësie prindërore, si dhe për çdo shkak tjetër.”

Pala ankuese, Shoqata, pretendon për diskriminim të të gjithë grave e vajzave, nëpërmjet përdorimit të gjuhës së urrejtjes, në intervistën e dhënë e transmetuar në kanalën YouTube, të Revistës Bordo.

Bazuar në LMD, pala ankuese/Shoqata “Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri”, në cilësinë e personit juridik, është subjekt i ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, dhe gëzon legjitimitim aktiv për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr. 521/1, datë 16.04.2025, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Shoqëria “Fole Publishing” shpk⁴ dhe Revista Bordo - Kanali YouTube, lidhur pretendimet e Shoqatës “Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri”.

⁴ Kanali zyrtar i Revistës Bordo menaxhohet nga Folé Publishing, bazuar në të dhënat e pasqyruara në faqen zyrtare: <https://www.youtube.com/channel/UCvRRhdj6rHqr4bceJT3YiiQ>

2. Nëpërmjet e-mailit datë 17.04.2025⁵, përfaqësuesja e shoqatës “Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri”, znj. I. L, ka informuar Komisionerin, se:

“... Ju bëjmë me dije që ankesa lidhur me këtë subjekt për gjuhë urrejtje në platformat online, përveç ankesës dërguar Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, rrjeti AWEN, i ka dërguar edhe Autoritetit të Mediave Audiovizive dhe Aleancës për Median Etike.

Ndërkohë me 25 Mars 2025, jemi njoftuar nga Aleanca Për Median Etike që Revista Bordo e ka hequr videon nga kanali youtube. Nuk kemi informacion të mëtejshëm.

Do kërkoninim nga ana e KMD marrjen e masave për reagim sa më të shpejtë në raste të ngjashme të përdorimit të gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit veçanerisht ndaj vajzave dhe grave.

Lidhur me arritjen e qëllimit, një pjesë e tij e lidhur me reagimin e Aleancës së Medias Etike, komunikuar edhe më poshtë, mendojmë që është arritur duke qenë se video është hequr nga kanali youtube, si pasojë e reagimit tonë. Në këtë mënyrë nuk do të ketë ndikim për persona të tjerë.”

3. Për sa më sipër, nga këqyrja dhe verifikimi i bërë nga KMD, në kanalin e Revistës Bordo në YouTube⁶, rezulton që video në fjalë, objekt i kësaj ankese është hequr nga faqja zyrtare në këtë kanal.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, Revista Bordo, ka reaguar pozitivisht dhe në mënyrë të menjëhershme, pas ankesave të paraqitura kundrejt saj, duke marrë masa konkrete, duke hequr videon nga kanali YouTube i saj.

Theksojmë se, Komisioneri ka patur dhe ka vazhdimisht në vëmendje, faktin që përdorimi i mjeteve audiovizuale apo rrjeteve sociale për të reklamuar, bërë publike qëndrime verbale, opinione apo veprime konkrete të personave të caktuar publikë apo subjekteve të ndryshme politike, të jetë i kujdesshëm dhe të mos ndikojë negativisht në përcjelljen e këtyre qëndrimeve që të mos kuptohen si deklarata fyese ndaj grupeve apo komuniteteve të veçanta të shoqërisë.

Në kuadër të ushtrimit të kompetencave që i jepen prej ligjit nr. 10221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për të siguruar mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin, si dhe përmbushjes së qëllimit të këtij ligji, për të garantuar të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit, mbrojtje të barabartë nga ligji dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka trajtuar edhe raste të tjera të gjuhës së papërshtatshme me konotacione diskriminuese nga persona publik, qofshin ata persona fizik apo juridikë.

⁵ Adminsitruar si provë në dosjen e subjektit ankues.

⁶ <https://www.youtube.com/@revistabordo>

Gjatë aktivitetit të tij, Komisioneri ka dënuar përdorimin e gjuhës fyese, shqetësuese, apo reklamave me natyrë seksiste apo diskriminuese ndaj një grupi apo komuniteti të caktuar, nga ana e individëve që bëjnë pjesë në jetën publike, qofshin ato subjekte fizike apo juridike.

Gjatë trajtimit të rasteve të ngjashme, Komisioneri ka kërkuar nga subjektet ndaj të cilëve është paraqitur ankesa, si masë rregulluese ndjesë publike në mënyrë që situata diskriminuese e pretenduar të marrë zgjidhjen e duhur e të mos përsëritet më në të ardhmen.

Për sa më lart, në kushtet kur subjekti ndaj të cilit ka nisur procedura hetimore ka reaguar në mënyrë të shpejtë duke hequr videon nga transmetimi në kanalin e saj në YouTube – Revista Bordo; Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson, se situata është rregulluar, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin është nisur ankesa, në drejtim të shqetësimit të krijuar në publik nga përdorimi i saj⁷.

Komisioneri vlerëson frymën bashkëpunuese të Revistës Bordo-Kanali TouTube, lidhur me reagimin e menjëhershëm duke hequr videon nga kanali i saj në YouTube, ku ishte e publikuar. Duke qenë se video është hequr dhe nuk transmetohet më, Komisioneri vlerëson se ajo (*sikurse e pranon dhe vetë pala ankuese*) nuk mund të ketë më asnjë ndikim tek shikuesit apo ndjekësit e këtij kanali/Reviste.

Neni 33, pika 9 e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ka parashikuar se: “Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër të cilit është paraqitur ankesa”.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se procedura administrative në lidhje me videon me titull: “A. L: “Nuk ka femra të vështira, ka femra që s’pinë alkool!”, e transmetuar me datë 14.03.2025, në kanalin YouTube të Revistës Bordo, duhet të deklarohej e përfunduar pa një vendim përfundimtar, pasi është arritur qëllimi dhe efektiviteti për të cilin ka filluar procedura administrative.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenet 3, 4, 7, pika 1, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma b) dhe c), si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7, 9 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

⁷ Për analogji të rastit citojmë vendimmarrjet e KMD-së me nr: 66, datë 23.06.2021, nr. 221, datë 16.11.2021.

Adresa: Rruga “Durrësit”, Nr. 27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, E-mail: info@kmd.al, Web: www.kmd.al

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative të shqyrtimit të ankesës nr. 67, datë 20.03.2025, të paraqitur nga shoqata “Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri”, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin është filluar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA